

NDËRTIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËS PEJË — LUMBARDH — MILISHEVC, NUK KA RAPORT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS



Kontrata e monitoruar
me numër të prokurimit
635/19/076/511, viti 2019.



Vlera e parashikuar e këtij projekti është 875,811.90 € për vitin 2019-2020 si dhe mjetet për vitin 2020 janë marrë nga Ministria e Infrastrukturës.



Shtatë (7) operatorë ekonomikë aplikuan dhe oferta më e lartë ishte 964,399.30€.



Kontrata është fituar nga **ILEAA-GR-SHPK & INFRA-PLUS-SHPK** nga Prishtina, me numër biznesi 810199035. (Në Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues respektivisht në Letrën standarde për tenderuesin e suksesshëm figuron të jetë nga **Deçani e jo nga Prishtina**).



Në dosjen e tenderit në e-prokurim **nuk gjendet raporti për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM)**, ndërsa dokumentet tjera të prokurimit janë të publikuara.



GJETJET KRYESORE


5 km e parapara në fazën e parë, nuk janë të asfaltuara.

Nuk na është ofruar qasje në Raportin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Rruga ka devijuar nga traseja ekzistuese dhe ka dëmtime të mëdha në florë dhe faunë.

Vetëm një shenjë është e vendosur në vend-punim kurse janë të buxhetuara 1,355.00 €.

Gjatë hulumtimeve online nuk kemi gjetë të dhëna në lidhje me mbajtjen e diskutimit publik.



REKOMANDIMET



Në secilin projekt të jetë i paraparë edhe ndikimi mjedisor (Raporti i VNM).



Të asfaltohen rrugët në trasenë ekzistuese.



Të rritet niveli i transparencës dhe llogaridhënies në të gjitha proceset tenderuese.